

Nr. Prot. 038/B/20

VENDIM Nr. 1615

Për

Fillimin e Procesit të Konsultimit Publik të dokumenteve për Analizën e Tregut

“Terminimi i thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike, neni 10, paragrafi 5), neni 31, paragrafi 8), neni 79, paragrafi 1) dhe 2) dhe neni 82 paragrafi 1) dhe 3) (*tutje referuar si - Ligji*); Rregullores Nr. 42 për Analizat e Tregut (*Ref. ARKEP Nr. Prot. 110/B/19*), neni 3, paragrafët 3.1) dhe 3.10) (*tutje referuar si - Rregullorja për Analizat e Tregut*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - ARKEP ose Autoriteti*), Bordi Drejtues i Autoritetit në përbërje prej:

- 1) z. Nijazi Ademaj Anëtar
- 2) z. Hazir Hajdari Anëtar
- 3) z. Bahri Anadolli Anëtar, dhe
- 4) z. Shqiprim Pula Anëtar,

pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE), lidhur me analizën e tregut dhe përcaktimin e operatorëve me Fuqi të Ndjeshme në Treg (OFNT), mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet fillimi i Konsultimit Publik të:
 - a) Draft Vendimi për Definimin e Tregut të Terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale.
 - b) Draft Vendimi për Përcaktimin e ndërmarrjes “Telekomi i Kosovës” Sh.A. si OFNT në tregun e Terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale.
 - c) Draft Vendimi për Përcaktimin e ndërmarrjes “IPKO Telecommunications” LLC si OFNT në tregun e Terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale.
 - d) Draft Vendimi për Përcaktimin e ndërmarrjes “mts” D.O.O. si OFNT në tregun e Terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale.

e) Raporti për analizën e tregjeve dhe përcaktimi i operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg – Terminimi i thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale.

II. Procesi i konsultimit publik fillon më datë **06 Gusht 2020** dhe përfundon më datë **05 Shtator 2020**.

III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 5) përcakton se Autoriteti: *“Miraton vendimet në lidhje me përcaktimin e tregjeve përkatëse, kryen analizat e tregut dhe imponimin, si dhe tërheqjen e obligimeve të rregullatorit tek operatorët me fuqi të ndjeshme tregu.”*

Neni 31 paragrafi 8 i Ligjit përcakton se: *“Autoriteti duhet ta kompletojë procedurën e analizës së tregut brenda katër muajve pas vendimit të Autoritetit referuar në paragrafin 1. të këtij neni për iniciimin e analizës së tregut. Autoriteti do t'i konsultojë palët relevante për draftin e vendimit të vet për rezultatet e analizës së tregut sipas procedurës së konsultimit për analizë të tregut e vendosur në nenin 82 të këtij ligji...”*

Neni 3.10 i Rregullores për Analizat e Tregut përcakton: *“Pasi ta ketë analizuar tregun përkatës, Autoriteti duhet të paraqesë një draft vendim së bashku me materialin përcjellës (duke i kushtuar rëndësi të duhur shënimeve konfidenciale) për konsultim publik sipas Nenit 82 të Ligjit për Komunikime Elektronike. Me përjashtim të rasteve si të specifikuara në nenin 31.9 të LKE. Një konsultim i tillë duhet të zgjasë për një periudhë jo më të shkurtë se një (1) muaj....”*

Neni 4.3.2 i Rregullores për Analizat e Tregut ka specifikuar listën e tregjeve të ndjeshme ndaj rregullimit *“ex-ante”* në Territorin e Republikës së Kosovës, ku ndër të tjera është edhe tregu:

- Terminimi i thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale.

Ky treg është në ciklin e tretë të analizës.

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t'i publikojë ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 29/07/2020

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Faqe 2 nga 3

Aktivendimi i dërgohet:

- Operatorëve të rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik/Departamenti i Postë Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informative
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike/Zyra për Analiza Ekonomike, ARKEP,
- Departamenti ligjor, ARKEP,
- Arkivit, ARKEP